



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr. 362/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtësen Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.GJ nga Mitrovica, nën dyshimin për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1643/2016, dt.06.06.2017, të cilën aktakuzën e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Jellena Marijanoviq, ka prezantuar i pandehuri B.GJ, e dëmtuara V.K, ndërsa pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publike në bazë të nenit 359, 360, 366 të KPP-së, me dt.07.05.2019, është marrë dhe publikisht është shpallur aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.28.05.2019.

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

B.GJ nga i ati Zh., e ëma V. e gjinisë Gj., i lindur me ..., me vendbanim në Rr. “...” pnr. i martuar, prind i 2 fëmijëve, punëtor sezonal, Sërb, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt.14.08.2016 rreth orës 21:10 min, në shtëpinë e prindërve të dëmtuarës V.K në ..., në rrugën “...” nr. ..., i pandehuri në gjendje të dehur e ka sulmuar bashkëshortën e tij- të dëmtuarën V.K, ashtu që fillimisht ka shkuar në shtëpinë e prindërve të të dëmtuarës duke kërkuar nga e dëmtuara që të kthehet në shtëpi, e kur e dëmtuara e refuzon duke kërkuar nga i pandehuri që të mos pi, atëherë i pandehuri në shenjë revolte sulmon të dëmtuarën duke e goditur me grushta në anën e majtë të fytyrës me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore- kontuzion në qafë dhe në mollëzën e faqës së majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryre veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykatat në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 50, 51, 52, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

SHQIPTON

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afta prej një (1) viti nëse i akuzuar gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20€, të gjitha këto afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm

Pala e dëmtuar ka deklaruar se nuk parashton kërkesë pasurore juridike.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1643/2016, dt.06.06.2017, ndaj të pandehurit B.GJ nga Mitrovica, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjyqtari ka caktuar seancat e shqyrtimi gjyqësor, ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike në këtë çështje është vazhduar me seanca e shqyrtimit gjyqësor dt.07.05.2019 dhe po të njëjtën datë është bërë edhe shpallja publike e aktgjykimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, palët janë njoftuar me të drejtat ligjore në këtë çështje penale, respektivisht i dëmtuari – dëshmitarët janë njoftuar në kuptim të nenit 125, 127, 129 të KPP-së po ashtu edhe të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2,3 të KPP-së, ndërsa e dëmtuara është njoftuar po ashtu me të drejtën e tij ligjore sipas nenit 322 par.2 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit gjatë këtij shqyrtim gjyqësor ka mbetur pranë akuzës, me një qëndrim të tillë ka mbetur edhe në paraqitjen e fjalës përfundimtare duke deklaruar, se mbetëm pranë aktakuzës, se i pandehuri ka kryer veprën penale sipas aktakuzës, se ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit, duke ekzistuar provat nga deklaratat të të dëmtuarës të dhënat paraprakisht, të dëshmitarit, raportet mjekësore mbi lëndimet e pësuar e dëmtuara po ashtu nga ekspertiza mjekoligjore vërtetohet se e dëmtuara ka pasuar lëndime të natyrës së lehtë trupore, duke marr parasysh të gjitha provat të cekura pa mëdyshje ekziston se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale, lëndim i lehtë trupore nga neni 188 para. 3 të KPRK-së dhe i pandehuri të shpallet fajtorë dhe të gjykohet sipas ligjit.

Pala e dëmtuar, në paraqitjen e fjalës përfundimtare ka deklaruar se jam e martuar me të pandehurin, kemi dy fëmijë, nuk kemi probleme, kërkoj që i njëjti të lirohet nga kjo akuzë.

Në fjalën përfundimtare i pandehuri B.GJ, ka deklaruar se me vjen keq krejt ajo çka ka ndodhur, i kërkoj falje edhe të dëmtuarës dhe i premtoj gjykatës se me asnjëherë nuk do të ndodhin, kam qenë në ndikim të alkoolit atë ditë, siç deklarova edhe me lart, nuk i kam shkaktuar lëndime trupore, kërkoj që të lirohem nga akuza .

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor janë proceduar në cilësinë e dëshmitarit –është ftuar e dëmtuara V.K po ashtu edhe dëshmitari E.S.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.30.04.2019 dëshmitarja – e dëmtuara V.K. e cila fillimisht është njoftuar me dispozitat ligjore sipas nenit 127 par.1 nën par.1.2 të KPP-së, pasi që e njëjta – dëshmitarja me të pandehurin janë në raport-respektivisht të pandehurin e ka bashkëshort, e njëjta ka deklaruar se nuk dua të dëshmoj lidhur me rastin, duke e shfrytëzuar mundësin ligjore sipas dispozitës së cekur më lart.

Në cilësinë e të dëmtuarës ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Po ashtu në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.07.05.2019 dëshmitari E.S, i cili ka deklaruar se të pandehurin e ka burrë të motrës, respektivisht të dëmtuarën e ka motër, është njoftuar me dispozitat ligjore sipas nën 127 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së, pasi që i njëjti me të pandehurin janë në raport-respektivisht i pandehuri është burrë i motrës, i njëjti ka deklaruar se nuk dëshiron që të dëshmoj lidhur me rastin, duke e shfrytëzuar mundësin ligjore sipas dispozitës së cekur me lart.

Në seancën gjyqësore janë lexuar, proceduar provat duke bërë leximi i procesverbalit mbi konstatimin e pranisë se alkoolit në organizëm i dt. 14.08.2016 për të pandehurin, vështrim në raportin mjekësorë për të dëmtuarën V.K e dt. 14.08.2016 me nr. protokollit ..., vështrim në ekspertizën mjekoligjore për të dëmtuarën V.K e dt. 14.05.2017 ku konstatohen se e dëmtuar ka pasuar lëndime të natyrës së lehtë trupore.

I pandehuri gjatë procedurës për marrjen në pyetje në cilësinë e të pandehurit në mbrojtjen e tij ka deklaruar se atë ditë kam shkuar të familja e bashkëshortes time, e njëjta ka shkuar me fëmijë, për shkak të përlëshjes që kemi pasur paraprake dhe e kam lutur që të njëjta të kthehet në shtëpi, të shtëpia e saj jemi përta – shtyrë me fjale, ajo me ka thënë se jam i dehur dhe nuk dëshiroj që të vij, fizikisht nuk e kam goditur, tani jam kthyer për në shtëpi, kam qenë në ballkon, nuk e kam goditur të dëmtuarën, tani me të dëmtuarën jetojmë bashkë, kemi dy fëmijë, alkoolin e kam zvogëluar, ka ndodhe edhe me herët se bashkëshortja ime ka shkuar dhe është larguar nga për shkak se kam konsumuar alkool, atë ditë kanë ardhur policia, me kanë takuar tek shtëpia, me kanë sjellur në stacionin policor, atje kam dhënë një deklaratë, kam bërë alkootestin, tani nuk kam probleme me të njëjtën.

Pas procedimit të provave materiale dhe atyre personale në këtë shqyrtim gjyqësor, paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët, të dëmtuarës dhe të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera gjykata në mbështetje të nenit 361 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata në veprimet e të pandehurit vërtetoi se ekzistojnë elementët e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPRK-së, duke pasur mbështetje në provat administruara në këtë çështje.

Gjatë administrimi të provave është vërtetuar fajësia e të pandehurit për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par. 3.1 të KPRK-së, pasi që në këtë çështje është vërtetuar se i pandehuri ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme në cenimin e integritetit trupor të të dëmtuarës, duke i shkaktuar lëndime të natyrës së lehtë trupore, kjo vërtetohet nga raportet mjekësore në emrin e të dëmtuarit V.K, nga vërtetimi i mjekut në Qendrën Mjekësore në Mitrovicë nr. ... dt.14.08.2016, ekspertiza mjeko ligjore për natyrën e lëndimeve trupore të pësuar e dëmtuara dt.14.05.2017, pjesërisht nga vetë deklarimi i i të pandehurit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, që nuk e mohon se paraprakisht kanë pasur përlëshje, se është konsumues i alkoolit, nga deklarata e dhënë në procedurën paraprake nga e dëmtuara dhe dëshmitari, të cilët në dëshmitë e tyre e vërtetojnë një fakt të tillë si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës, kjo duke u vërtetuar me provat material siç janë raportet mjekësore dhe ekspertiza mjekoligjore që janë në lidhshmëri njëra me tjetrën, të gjitha këto vërtetojnë akuzën ndaj të pandehurit i cili ka ndërmarrë veprime të paligjshme në rastin konkret Gjykata në mënyrë të plotë dhe të qartë vërtetoi se janë përmbushur të gjitha elementët e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 KPRK-së.

Gjykata në vlerësimin e mbrojtjes së të pandehurit, e cila mbrojtje e të pandehurit është refuzuar e pa bazuar me pretendimin e shmangies nga përgjegjësia penale dhe se deklarimi i të pandehurit është i pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e procedura në këtë çështje penale të konstatuar me lart, i pandehurin nuk i ka ofruar gjykatës fakte, prova të cilat kishin me ndryshuar gjendjen për një vendim marrje tjetër, andaj mbrojtja e të pandehurit është pa qëndrueshme dhe pa mbështetje në fakte, pasi që vetë i pandehuri nuk e mohon veprimin e fjalosjes me të dëmtuarën.

Provat e proceduara janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykim, të konstatuara si me lart dhe të gjitha këto janë të qëndrueshme, të mbështëtura në prova materiale, nga raportet mjekësore, ekspertiza mjekoligjore për natyrën e lëndimeve të pësuar e dëmtuara, andaj gjykata ka krijuar bindjen e plotë duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në vlerësimin e të gjitha rrethanave në mbështetje të provave personale dhe prova materiale se pa asnjë dyshim dhe në mënyrë bindëse për gjykatën vërtetohet se në veprimet e të pandehurit janë manifestuar veprime të kundërligjshme në krijimin e elementeve të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPRK-së, duke e shpallur fajtor të pandehurin për këtë vepër penale siç konstatohet në dispozitiv të Aktgjykimit.

Në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin përjashtuar përgjegjësin penale për të pandehurin në këtë çështje penale në kuptim të nenit 17 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethanë lehtësuese mori për bazë faktin se i pandehuri është prind – baba i dy fëmijëve, shprehjen e keqardhjes, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të ketë probleme me të dëmtuarën, gjendjen jo të mire ekonomike, bashkëjetojnë, pas rastit nuk kanë pasur probleme, deklaratimet e të dëmtuarës se dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese që ka të bëjë me këtë çështje penale, mori për bazë mënyra e kryerjes së veprës penale, ndjeshmërinë e çështjes raportet familjare, cënimi i trupit dhe shëndetit të të dëmtuarës, i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen me të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, duke pasur efektin e vet në parandalimin e kryerjes nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimin i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Shpallja e aktgjykimit është bërë me dt.07.05.2019, në seancë të hapur dhe publike, në prezencë të pandehurit, të dëmtuarës, ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e ka marrë konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike në mbështetje të nenit 461 të KPP-së.

Nga theksimet e theksuara si me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.362/2017 dt.28.05.2019

**Procesmbajtësja
Valdete Sadiku**

**Gjyqtari
Bekim Veliqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.